



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 525/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-sw në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z., Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “NNT Eing Com” – Podujevë, kundër kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Rikonstruimi i rrugëve Drenica, Ukshin Hoti, Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistrukturës së rrugës Enver Maloku”, me nr. prokurimi: 616-18-5059-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë, më datën 24.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “NNT Eing Com” – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i rrugëve Drenica, Ukshin Hoti, Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistrukturës së rrugës Enver Maloku”, me nr. prokurimi: 616-18-5059-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Rikonstruimi i rrugëve Drenica, Ukshin Hoti, Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistrukturës së rrugës Enver Maloku”, me nr. prokurimi: 616-18-5059-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK – Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “NNT Eing Com” – Podujevë aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 13.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 02.08.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderues të eliminuar 14.09.2018

Data e kërkesës për rishqyrtim 18.09.2018

Autoriteti Kontraktues me datën 19.09.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE “NNT Eing Com” – Podujevë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “NNT Eing Com” – Podujevë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 08.09.2018 me nr. 525 / 18, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Rikonstruimi i rrugëve Drenica, Ukshin Hoti, Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistrukturës së rrugës Enver Maloku”, me nr. prokurimi: 616-18-5059-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat e LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.10.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 10.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues “NNT Eing Com” – Podujevë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të

prokurimit, konstaton si në vijim:

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së FDT-së, në lidhje me makinerin e kërkuar për këtë projekt, për të cilin është eliminuar OE ankues, sa i përket kërkesës të FDT-së 9.1&9.2 nënpika 13 tek Makineri ku është kërkuar: Cilinder me rrota hekuri me vibrim 12T.

Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së, sepse në bazë të pretendimit ankimor dhe dokumentacionit të ofruar për këtë paisje (Cilinder), sa i përket eliminimit të OE ankues i njehti ka ofruar cilindër me vibrim Marka Amman, me rezvuar uji deri 2000kg, Tipi 95AV, ku dëshmohet përmes dud-it Doganor pesha Bruto dhe Neto 10000kg, por në të njëjtin dokument DUD, dëshmohet pesha e rezvuar uji 2000kg dhe gjithashtu në tiketën CE të Makineris (cilindër) shkruan pesha totale 12000kg andaj Autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 72 të LPP-së duhet të sqaroj këtë Makineri se e njëjta a është konform kërkesës të dosjes së tenderit ku është kërkuar në piken 13 tek Makineria Cilinder me rrota hekuri me vibrim 12T.

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së FDT-së, për makinerin e kërkuar për këtë projekt, për të cilin është eliminuar OE ankues, konkretisht sa i përket kërkesës FDT-së pika 9.1&9.2, nënpika 11 tek Makineri ku është kërkuar: Finisher për shtrirjen e Asfaltit, të dëshmohet me dud-Doganor. Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit të ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 59.4 të LPP-së, si dhe kërkesës të FDT-së të lartë cekur sepse në bazë të pretendimit ankimor dhe dokumentacionit të ofruar për këtë paisje (Finisher), NUK qëndron pretendimi ankimor sa i përket kësaj pike të OE ankues, sepse i njehti OE ankues ka ofruar faktur për këtë makineri e cila nuk plotëson kriterin e dosjes së tenderit dëshmia dokumentare për makineri pasi që për të njëjten duhet të ofroj dud-Doganor apo në rast të rexhistrimit të Makineris Librez të qarkullimit sipas kërkesës të FDT-së.

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së FDT-së, në lidhje me makinerin e kërkuar për këtë projekt, për të cilin është eliminuar OE ankues, sa i përket kërkesës pika 9.2, nënpika 3 tek Makineri në lidhje me këtë kërkes sa i përket Ngarkuesit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, si dhe kërkesës të FDT-së lartë cekur sepse në bazë të pretendimit ankimor dhe dokumentacionit të ofruar për këtë paisje, pasi që paisja lug-ngarkuesit janë të ndryshme dhe mundet të përdoren sipas nevojës së paraqitjes, në rastin konkret Autoriteti kontraktues ka

nxjerrur nga Katalogjet e Prodhuesit kapacitetin e këtyre paisjeve por të njëjtat dëshmi nuk janë marrur (katalogje) nga ana e OE ankues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në këtë rast është dashur të kërkoj sqarim në bazë të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, për të vërtetuar këtë paisje apo të për të njëjtat të vërtetoj edhe teren nëse është nevoj për të ardhur deri tek

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues NNP "EING COM" – Prishtinë, të Aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet e lartë cekura), njëherit rekomandoj që të mbetet në fuqi vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 12.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 10.10.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 24.10.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesit e autoritetit kontraktues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Podvorica deklaroj: Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit për mbetje në fuqi të vendimit të AK-KK Prishtinë, për arsye se në ankesën tonë me datë 28.09.2018 për këtë aktivitet të prokurimit gjithsej kanë qenë 3 pretendime ankimore, dy prej të cilave na janë aprovuar ng aeksperti ndërsa njëra jo. Pretendimi që nuk është pranuar është për pajisjen Finisher, që është prezantuar kontrata për qiramarrje të makinerisë në mes te kompanisë El Bau dhe Eing Com e që është konform kërkesave të dosjes së tenderit. Pajisja në fjalë ka qenë pronë e kompanisë Magjistralka qysh në kohën e Ish Jugosllavisë. Makinaria është prodhim i Sebrbisë i vitit 1994 dhe rrjedhimisht nuk ka dud doganor.

Ne për këtë në dosje të tenderit kemi bashkangjitur kontratën e makinerisë, dhe faturën e shitblerjes me të Magjistratën shpik dhe El Bau. Për më tepër vërtetësia për ekzistencën e kësaj makinerie është bërë edhe nga noteri përmes procedurës EN Minutes. Ja ofroj panelit si provë Listën e noterizuar EN Minutes ku shihet se është e përfshirë edhe makineria e kontestuar prej AK. Për shkak kapacitetit të lugës ngarkuese, është arsye absurde arsyetimi i AK-së sepse është kërkuar deri 1.5 metër kapaciteti i lugës, dhe ne emi ofertuar në pajtim me kërkesën e AK. Për më tepër AK sipas nenin 59.2 dhe 52.7 të LPP mund të kërkojë sqarime me shkrim për gjitha aspektet e tenderit apo ndonjë informacioni tjetër ose të dalë në teren dhe të bëjë verifikimin e makinerive. Për më tepër sa i përket këtyre makinerive ne kemi marrëveshje për furnizim dhe shtrim të asfaltit. Për makinerinë Cilinder me rrota, me vibrim 12 ton, ne vet pajisjen dhe dud doganor shkruan se pesha vetanake është 10.000kg plus 2.000kg rezervari i ujit, që në total bëjnë 12.000kg dhe rrjedhimisht është sipas kërkesës së AK. I propozojmë panelit të aprovohet ankesa dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Bajrami dekaltoj: KK Prishtinë mbështet mendimin e ekspertit lidhur me anulimin e këtij aktiviteti. Sa i përket pretendimeve të OE ankues çka dua të shtoj është se në dëshmitë është kërkuar dud doganor apo në rast regjistrimi të makinerisë librezë qarkullimit sipas kërkesës së FDT. Ndërsa sa i përket lugës ngarkuese sipas ekspertëve që kemi pas në komision vlerësues asnjë prodhues nuk parasheh mundësinë teknike që lugët e ndryshme të përdoren në mjetin e njëjtë pasi që kapaciteti i lugës duhet të jetë në harmoni me kapacitetin e mjetit që në këtë rast nuk është dëshmuar prej OE ankues. Cilindri pesha bruto është paraqitur të jetë 10.00KG dhe pesha neto 10.000kg që tregon qartë peshën e mjetit të OE ankues në këtë rast. Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së si dhe mbështesim rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së FDT-së, në lidhje me makinerinë e kërkuar për këtë projekt, për të cilin është eliminuar OE ankues, ku në nenin 9.1&9.2 nën-pika 13 tek Makineria është kërkuar: Cilinder me rrota hekuri me vibrim 12T, konstaton se autoriteti kontraktues ka mundur të sqarojë këtë çështje konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, sepse OE ankues për pajisjen (Cilinder), ka ofruar cilindër me vibrim Marka Amman, me rezervuar uji deri 2000kg, Tipi 95AV, dhe është dëshmuar përmes DUD-it Doganor pesha Bruto dhe Neto 10000kg. Gjithashtu në DUD, dëshmohet pesha e rezervuar uji 2000kg, e po ashtu në tiketën CE të Makinerisë (cilindër) shkruan pesha totale 12000 kg.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se është eliminuar pa të drejtë përkitazi me, kërkesën e FDT-së pika 9.1&9.2, nënpika 11 ku është kërkuar: Finisher për shtrirjen e Asfaltit, të dëshmohet me dud-Doganor, paneli shqyrtues konstaton se OE ankues ka ofruar faturë për këtë makineri, e jo DUD siç është kërkuar, prandaj ky OE ekonomik nuk e ka plotësuar kërkesën e lartpërmendur të dosjes së tenderit, ku është dashur të ofrohet DUD-Doganor apo në rast të rexhistrimit të Makinerisë Librez të qarkullimit sipas kërkesës të FDT-së.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se është eliminuar pa të drejtë, sa i përket kërkesës tek pika 9.2, nënpika 3 përkitazi me Ngarkuesit, paneli shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, në raportin e vlerësimit të komisionit vlerësues, pretendimet ankimore të OE ankues konstaton autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në harmoni me nenin 44.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pika (ii).

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinë

1x1 OE-“NNT Eing Com” – Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

